

Lamtumire Xhek nga Xhek London
Perkthyer nga Violeta Volumi

Ishujt Hawai jane nje vend i cuditshem. Ne aspektin social eshte si te thuash rrumuje. Por jo se mungon korrektesa, perkundrazi ka bilez me tepri. E megjithate situata eshte konfuze. Grupi me i rendesishem eshte Klani i misionareve. Te habit fakti qe Misionari i Zi, qe e do aq shume martirizimin, ulet ne krye te tavolines , bashke me aristokracine e pasur te vendit. Po ja qe, keshtu eshte. Qytetaret modeste qe kane ardhur ne ishull nga New England, ne dhjetevjecarin e trete te shekullit XIX, kishin ardhur me qellimin fisnik qe ti mesonin Kanakasve besimin e vertete, kultin e te vetmit zot te vertete. E ja dolen mbane aq mire ne synimin e tyre dhe ne civilizimin e indigjeneve, sa qe brenda gjenerates se dyte apo te trete, popullsia Kanaka, praktikisht u shfaros e gjitha. Ky ishte fruti i Ungjillit, kurse fruti i fares se misionareve, femijeve dhe nipave te tyre, ishte se ato u bene pronare te ishujve, te tokes, te porteve te qyteteve dhe te plantacioneve te sheqerit. Misionari qe kishte ardhur per tu dhene buken e jetes, perfundoi tu kullufiste te gjitha banketin paganeve.

Por nuk eshte kjo cudia per te cilen ju fola ne fillim. Por nuk mund te flasesh per Hawain pa folur per misionaret. Le te marrim per shembull Xhek Kersdejl. Per te, desha tju tregoj. I perkiste klanit te misionareve, se paku nga ana e gjyshes. Gjyshi ishte Benxhamin Kersdejl, nje tregtar Yankee, qe ne kohen e tij kishte fituar milionin e pare duke i shitur whiskey e gin te cilesise me te keqe, aristokracise se vendit. Ka edhe nje gje tjeter te cuditeshme. Misionaret e vjeter dhe tregtaret e vjeter ishin armiq per vdekje. Interesat e tyre ishin ne konflikt me njeri tjetrin. Por femijet e tyre, i dhane fund kesaj urrejtjeje duke u martuar me njeri tjetrin dhe keshtu e ndane ishullin ne mes te tyre.

Jeta ne Hawaii eshte nje kenge. Keshtu thoshte Stoddard ne "Hawaii Nei:"

"Jeta eshte nje muzike notat e se ciles Fati i zgjat!"

Cdo ishull eshte nje strofe, dhe te gjitha bashke bejne nje kenge."

Dhe kishte te drejte. Atje ngjyra e trupit eshte ngjyra e arit. Grate indigjene jane si perendesha Hera, te rritura ne diell , kurse burrat si Apolone ngjyre bronxi. Kendojne e vallzojne te gjitha te zbkuruar me kurora lulesh, e pervec misionareve te ngurte, te bardhet i dorezohen klimes dhe diellit dhe sado pune qe te kene , nuk e humbin kurre rastin per te kenduar e vallzuar e te vene lule pas veshit e neper floke. Jack Kersdejl nuk bente perjashtim. Ishte njeri nga njerezit me aktiv qe kam njohur ndonjehere. Stermilioner . Ai ishte mbreti i sheqerit dhe nje pionier i kultivimit te kaucukut, zoteronte gjitha plantacionet e kafese dhe fermave te kafsheve. Ishte pronari i trecerekut te ndermarrjeve te reja ne ishujt. Ishte nje njeri mondan, antar i gjitha clubeve, i apasionuar me varkat, velat, nje beqar mjaft i bukur, i tille qe cdo nene do te donte ta martonte me te bijen. Kishte perfundur studimet ne Yale (Jeill), dhe e kishte koken plot me statistikat baze e informacione qe lidheshin me Akademin e Hawai Nei, me shume se kushdo tjeter qe kam njohur e takuar ne ishull. Arrinte te bente pune gjiganteske dhe te kendonte, vallzonte e vinte lule neper floke si te ishte nje i papune.

Kishte shume energji, kishte bere dy duele, e qe te dyja per arsye politike. Ne fakt gjate permbysjes se dinastise indigjene, luajti nje rol shume te rendesishem duke treguar shume guxim. E ne ate kohe nuk ishte me shume se gjashtembdhjete vjec. Po ju tregoj se nuk ishte nje frikacak, kurrsesi. E per te kuptuar ate qe ndodhi me vone ju them se e kam pare kur u ca rrethimi i Haleakala Ranch, ne garen e kuajve dhe arriti te shtronte nje kale te eger 4 vjecar qe per dy vjet kishte sfiduar kaubojin e famshem te Von Tempsky. E me duhet tju them edhe nje gje tjeter. Kjo ndodhi ne Kona-up . Ndodheshim ne veranden doktor God-hue. Isha duke biseduar me Dottie Fairchild kur ndodhi kjo. Nga traret lart, i ra ne floke nje shumekembesh i madh 15 centimeter i gjate, qe e matem me vone. Ju rrefej se kur pashe ate kafshe te sikleteshme, tmerri me paralizoi, nuk arrija te levizja. Mendja refuzonte te punonte. Dy hapa

larg meje, kjo kafshe e tmerreshme, helmuese sperdridhej ne mes te flokeve te vajzes , duke rrezikuar ti binte nga casti ne cast ne shpatullat e zbuluara te saj, se sapo kishim dale nga salla e bukes.

"Cfare ka?" pyeti, dhe ne menyre instinktive deshi te conte doren ne koke.

«Jo!" bertita. "Ndalo!"

"Po cfare eshte?"- kembenguli ajo e tmerruar nga tmerrri qe lexonte ne syte dhe buzet e mija qe dridheshin. Britma ime terhoqi vemendjen e Kersdejlit. Shikoi si me shkujdesje nga ana jone , dhe me nje shikim te vetem kuptoi gjithcka. U drejtua nga ne , por pa u ngutur.

"Te lutem Dotti, mos leviz,- tha ngadale. Nuk hezitoi as edhe per nje cast, por veproji me shume qetesi, pa bere rrumuje.

"Me leje," tha.

Me nje dore mori shallin, ja mbeshfolli kraheve ne menyre qe shumekembeshi te mos i binte ne pjesen e zbuluar, dhe me doren tjeter, te djathten, e kapi ate kafshe te sikleteshme sa me prane kokes dhe e shtrengoi fort mes gishtit te madh e gishtit tregues ndersa po ja hiqte nga floket. Qe nje skene e tmerreshme dhe heroike qe ma ngjethi mishin. Shumekembeshi 15 centimetrash perdridheji egersuar ne doren e tij me trupin e kembet qe i kapeshin pas gishtave te tij e i nguleshin ne lekure duke e gervishur ndersa po perpiqej te clirohej prej tij, e thumboi dy here. E pashe me syte e mi. Ai i siguroi grate se nuk kishte bere asgje, ndersa po e hidhte kafshen ne zall dhe po e shtypte me kembe. Por pas pese minutash ishte ne infermierine e doktor God-hy qe po ja pastronte plaget e i hidhte permanganat kaliumi. Mengjezin tjeter Kersdejl e kishte krahun te enjtur sa nje fuci dhe iu deshën tre jave per ti ikur e enjtura. E gjitha kjo nuk ka asnje lidhje me historine time por nuk mund te mos ju flisja per kete per tju treguar se Xhek Kersdejl mund te ishte gjithcka por jo frikacak. Ishte nje cfaqje jashtzakonshe e guximit, e nuk iu drodh qerpiku dhe as per nje cast buzeqeshja nuk ju largua nga fytyra. Zhyti gishtin e madh dhe tregues mes flokeve te Dotti Fairchild si te fuste doren ne nje kuti me bajame te kripura. E pra , po kete njeri do ta shikoja te paralizuar nga nje frike nje mije here me te tmerreshme se ajo qe provova une kur pashe ate kafshe te tmerreshme.

Isha i interesuar mbi studimet e lebres , dhe per kete argument sikurse per cdo tjeter qe lidhej me ishullin, Kersdejl kishte njohuri enciklopedike. Ne fakt, lehren e kishte fiksime. Ishte nje mbeshfollet i zjarre i Molokai, ku mbaheshin te izoluar te gjithë te semuret me leber. Mes popullates se ishullit tregoheshin shume legjenda te ekzagjeruara te ushqyera nga demagoget lidhur me mizorite ne Molokai, ku burra e gra te braktisur nga miqte dhe te afermit, ishin te detyruar te jetonin ne burgim te perjetshem deri sa te vdisnin. Ne hyrje te Molokai, ashtu si ne porten e ferrit ishte e shkruar: O ju qe hyni ketu, lini cdo shprese!

"Ta them une, se atje jane te lumtur ", insistente Kersdejl. "Dhe jane shume me mire se miqte e te afermit e tyre qe nuk kane semundje . Tmerret e Molokait, jane te gjitha budallalleqe.

Mund tju them se ne cfaredo spital apo ne periferie e shume metropoleve shihen tmerre mijra here me te medha. Te vdekurit e gjalle! Krijesat qe dikur ishin njerez! Budallalleqe. Do te duhej te shihje ato te vdekur te gjalle qe organizojne gara me kuaj me 4 korrik. Ka prej tyre qe kane edhe barkat e tyre. Disa kane edhe Makine Lancia me benzine. Kane ushqime, banesat e tyre, rroba, asistence mjeksore, gjithcka. Jane rojet e territorit. Kane nje klime shume me te mire se ajo e Honoluluse, pejsazhi eshte i mrekullueshem. Nuk do te me vinte keq po te me duhej te kaloja atje gjithë jeten time. Eshte nje vend magjepses. "

Keshtu fliste Kersdejl per jeten idilike te lebrozeve. Nuk i trembej lebres. Te pakten keshtu thonte dhe mendonte se shanset per te si per cdo te bardhe per tu prekur nga ajo semundje ishin nje nder nje milion. Pastaj me vone me rrefeu se nje ish shoku i tij i shkolles, Alfred Starter, ishte semure me leber, kishte shkuar ne Molokai, dhe aty kish vdekur.

"Dikur," –shpjegonte Kersdejl,- "nuk ekzistonte ndonje test i besueshem per lehren.

Mjaftonte cfaredo simptome jo e zakonte apo jo normale e te dergonin ne Molokai. Rezultati ishte qe aty derguan me dhjetra persona qe nuk ishin me shume lebroze se une e se ti. Por sot

nuk behen me gabime te tilla. Testet e Ministrise se shendetesise jane te pagabueshem . Gjeja me qesharake eshte se kur u zbulua, menjehere u bene testet tek banoret e Molokait dhe u gjeten disa te cilet nuk e kishin ate semundje. Dhe u larguan menjehere prej aty. E ti mendon se ishin te lumtur qe te iknin qe aty? Qane me shume se kishin qare kur ishin larguar nga Honoluluja per te shkuar atje. Disa refuzuan te largoheshin dhe i detyruan te largoheshin. Njeri prej tyre u martua me nje lebroze ne graden e fundit , dhe filloi ti shkruante letra patetike Ministrise se Shendetesise, duke protestuar kunder largimit te tij dhe duke thene se askush nuk ishte ne gjendje ti perkujdesej se shoqes si ai. "

" E cili eshte ky test i pagabueshem? " – e pyeta.

"Analiza bakteriologjike. S`ka gje per tu gabuar. Doktor Hervey-specialisti jone- ka qene i pari qe e ka praktikuar ketu, eshte nje magjistar i vertete. Ai e njeh lehren me mire se kushdo tjetere ne bote. E ne se do te gjendet ndonjehere ndonje kure, ai qe do ta zbulojte s`mund te jete tjetere vecse ai. E persa i perket testit, eshte shume e thjeshte, kane arritur te izolojne bacilin e lebres dhe e kane studjuar. Tani, sapo e shohin ne mikroskop, jane ne gjendje ta njohin. I merret nje cope lekure pacienti te dyshuar dhe i bejne analizen bakteriologjike. Edhe nje njeri qe nuk ka asnje shenje mund te jete me bacilet e lebres. "

" Atehere edhe ne, -"i thashe,-" mund ti kemi ato. »

Kersdejl mblodhi supet dhe filloi te qeshte.

" E kush mund ta dije? Periudha e inkubacionit eshte 7 vjet. Po te kesh ndonje dyshim shko e takoje doktor Hervey. Do te te marre nje cope lekure e sa hap e mbyll syte, ta thote rezultatin. "

Me pas me prezantoi me doktor Hervey, qe me mbuloi me raporte te Ministrise se Shendetsise dhe fletepalosje per kete argument e me coi ne Kalifi, qendra e pranimi ne Honolulu, ku beheshin testet dhe mbaheshin te semuret ne pritje per ti nisur ne Molokai. Keto dergime beheshin nje here ne muaj. Pas lamtumirave te fundit, lebrozet ngarkoheshin ne piroskafin Noeu e tranportoheshin drejt kolonise.

Nje pasdite, ndersa po shkruaja disa letra, erdhi te me takonte Xhek Kersdejl.

"Po te kerkoja," – me pershendeti-. "dua te te tregoj pamjen me te trishtueshme te gjithe kesaj historie- te qarat e lebrozeve ndersa nisen per Molokai. Imbarkimi ne Noeu do te behet pas pak minutash. Por mos u deshperoni, edhe pse do te jete e veshtire te asistosh ne dhembjen e tyre , se pas nje viti, dhembja e tyre do te ishte edhe me e madhe ne se Ministria e Shendetsise do te perpiqej ti largonte nga Molokai. Kemi kohe vetem per te pire nje whisky e soda, do te me gjesh ketu jashte. Duhet vetem pese minuta per te shkuar tek porti. "

U nisem per port. Te ulur ne mes shtrojeve, mbulesave e bagazheve te cdo lloji ndodheshin nja 40 te shkrete. Piroskafi Noau sapo kishte arritur dhe po ankorohet buze molit. Nje fare zoti McVeigh, pergjegjes i operacionit po mbikqyrte imbarkacionin. Iu prezantova atij dhe doktor Xhorxhit, njeri nga keshilltaret e Shendetsise te cilin e kisha takuar ne Kalihi.

Lebrozet dukeshin qe te gjitha te deshperuar. Fytyrat e tyre ishin te frikesuara, shume te frikesuara qe te mund ti pershkruaj. Por aty ketu pashe edhe njerez ne dukje te shendoshe, pa asnje shenje te dukshme te semundjes. Mes te tjereve, pashe nje vajze te bardhe, jo me shume se 12 vjece, me syte e kalter dhe me floke te arte . Ne njeren faqe dukej e fryra e lebres. Kur vura re se sa e trishtueshme ishte situata e saj ne mes te gjithe atyre te semureve me lekure e erret, doktor Xhorxh mu pergjigj:

"Oh, nuk e di. Per te eshte nje dite e lumtur. Ajo vjen nga Kauai. Babai i saj eshte i keq. Dhe tani qe eshte semurur , do te bashkohet me te emen ne koloni. Nena e saj eshte atje prej 3 vitesh dhe eshte ne gjendje shume te rende.

"Jo gjithmone mund te gjykohen gjerat nga aparencat ", shpjegoi zoti McVeigh "Ai burri atje, ai tipi i shendoshe, qe duket pa asnje problem, ka nje plage te ulcerizuar ne kembe, nje tjetere ne shpatull. Dhe ka edhe te tjere. A e shikon doren e asaj vajzes, qe po pi cigare, shikoja gishtat . Ajo eshte nje forme pa dhembje. I sulmon sistemin nervor. Mund tja presesh gishtat

me thike te mprehur keq, apo tja grish me grirese nuk do te provoje as dhembjen me te vogel.
"

" Po ajo gruaja atje, nuk mund te kete asgje, eshte e pamundur! ", insistova; "eshte shume e bukur e duket si mbretereshe.

"Nje rast me te vertet i trishtueshem," pohoi zoti McVeigh , duke ja kthyer krahet e duke iu larguar molit se bashku me Kersdejl.

Ishte nje grua e mrekullueshme me gjak te paster polinezian. Nga ajo pak qe dija mbi racat dhe tipat, ishte pasardhese e fisit te kapove. Nuk duhej te ishte me shume se 23 apo 24 vjece. Trupi i saj ishte gjithë harmoni, dhe sapo fillonte te tregonte hiret e races se saj.

"Ka qene e rende per te gjithë ne", nderhyri Dr. Xhorxhi. "U paraqit vete vullnetarisht.

Askush nuk dyshonte. Kushedi se si e ka marre semundjen. U tronditem te gjithë. E mbajtem shtypin larg. Askush pervec nesh e familjes nuk di asgje. Kedo qe te pyetesh ne Honolulu, do te thote se do jete ne ndonje vend ne Europe. Ka qene vete ajo qe na ka kerkuar te mos e merrte vesh askush. E shkreta vajze!

-"Po kush eshte?", pyeta. « nga menyra se si flisni duhet te jete e rendesishme."

-"Nuk ke degjuar ndonjehere te flitet per Lucy Mokunui?"

- "Lucy Mokunui?" perserita , i turbulluar nga nje perceptim i njohur . Tunda koken. --"Me duket se ja kam degjuar emrin , por s`e mbaj mend."

"Po si ka mundesi? Nuke njeh Lucy Mokunui! Bilbilin e Hawaii! Me falni. Po sigurisht, ju jeni nje malahini dhe jeni ketu prej pak kohesh. E pra, Lucy Mokunui ka qene gruaja me e dashur ne Honolulu, bilez ne gjithë Hawaii.

" Ju thoni Ishte ", e nderpreva.

" Sakte. Tani ka mbaruar gjithcka. "- e mblodhi shpatullat me keqardhje.- " Te pakten nja nje duzine te bardhe kane lene koken per te, pa llogaritur peshqit e vegjel. Ishin njerez me prestigj, kishin pozite te larte ne shoqeri. Do te kish mundur te martohej me djalin e kryetarit te gjykates, po te kishte dashur. Ti mendon se ishte vetem e bukur? Por po ta kishte degjuar te kendonte. Kengetarja me e mire indigjene e Hawai Nei. Gryka e saj ishte argjend i paster dhe diell. Ne e adhuronim. Ka bere nje turne te pare ne Amerike me Royal Hawaiian band. Pastaj ka bere dy te tjere per llogari te vet, ka dhene koncerte..."

" Oh! " Thirra. "Tani me kujtohet! Para dy vitesh e kam pare te performonte ne Boston Symphony. Qenka ajo! Tani, po qe e njoh."

Nje trishtim i madh po me shtypte. Jeta ishte nje gje e kote, per te mos thene me keq. Vetem dy vjet kishin kaluar dhe kjo krijese e mrekullueshme, ne kulmin e suksesit te vet spektakolar, ishte bashke me nje turme lebrozesh, duke pritur izolimin ne Molokai. Mu kujtuan vargjet e Hemley:

Plaku endacak ekspozon plaget e shkreta te vjetra
dhe ato jane Tmerr dhe turp

Nuk guxoja te mendoja per te ardhmen. Ne se Lucy Mokunuit i kishte rene ne fat kjo pjese, cfare fati mund te me rezervohej mua, apo kujtdo tjetere? E dija qe ne jete jemi gjithnje te rrethuar nga vdekja, por te gjendeshe ne mes te atyre te vdekurve te gjalle, te vdisje pa vdekur akoma, te ktheheshe ne ato qenie te paforme qe dikur keta krijesa ishin burra dhe gra. Si Lucy Mokunui, personifikimi i gjithë hireve te gruas polinesiane, per me teper nje artiste, gruaja me e dashur nga te gjithë grate... Tronditja , duhej te me lexohej ne fytyre sepse doktor Xhorxhi, u nxitua te me siguronte se ishin shume te lumtur ne ate koloni. Ishte gjithcka teper pabesueshmerisht monstruoze. Nuk mund ta duroja pamjen e kesaj gruaje nga afer. Pas nje litari te tendosur te ruajtur nga policet ishin familjaret dhe miqte e lebrozeve. Nuk mund te afroheshin me shume. Nuk lejoheshin as perqafime dhe as puthje. I therrisnin njeri tjetrit. Mesazhet e fundit, thirrjet e fundit te dashurise, porosite e fundit dhe ato pas litarit kishin disa shikime tmerresisht intensive. Ishte hera e fundit qe shikonin fytyrat e te dashurve te tyre. Aty ishin te vdekurit te gjalle dhe anija funerare po i merrte me vete per ti derguar ne varrezat e

Molokai. Doktorin beri nje shenje. Te shkretet u ngriten ne kembe dhe nen peshen e bagazheve u afruan duke u lekundur drejt bordit te piroskafit. I ngjasonte nje kortezhi mortor. Renkime, ofshama , te qara u ngriten lart nga turma pas litareve. Te behej gjaku akull. Te coptohej zemra. Nuk kisha degjuar kurre nje gje te tille e shpresoj te mos e degjoj kurre me.

Kersdejl dhe McVeigh ishin akoma nga ana tjetere e molit, e po flisnin gjithnje seriozitet per politike. Qe te dy ishin fanatike te atij argumenti. Kur Lucy Mokunui me kaloi prane, i hodha vjedhurazi nje shikim. Ishte me te vertete e bukur. Per te gjitha shijet, nje nga ato lulet e rralla qe celin vetem nje here ne gjenerata e gjenerata., dhe nga te gjitha grate, pikerisht ajo, ishte e destinuar per Molokai. Ecte si nje mbretereshe. Kaloi bankinen dhe u ngjit ne bord duke u drejtuar nga kici , ne bordin e te cilit lebrozet u grumbulluan per te pershendetur ne mes ngasherimave e te qarave, te dashurit ne toke.

Noeu u shkeput nga moli. Te qarat u shtuan. Sa dhembje, sa deshperim! Po mendoja se nuk do te asistoja kurre me ne nisje tjetere te Noeu, kur u kthyen McVeigh e Kersdejl. Syte e mikut tim shkelqenin e nuk arrinte te fshihte nje buzqeshje kenaqesie. Me sa duket biseda per politiken e kishte kenaqur. Litari ishte hequr dhe familjaret ishin grumbulluar ne bankinen rreth nesh.

"Ajo eshte e ema," murmuriti Doktor Xhorxhi, duke me treguar nje grua prane meje qe lekundej sa para prapa e duke shikuar me sy te mjegulluar nga piroskafi. Vura re se edhe Lucy Mokunui po qante. Pastaj, papritur u ndal dhe shikoi Kersdejl. Zgjati krahet perpara ne te njejten menyre te adhurueshme e sensuale si Olga Nethersole perqafonte publikun dhe thirri :

"Lamtumire, Xhek! Lamtumire!" Kersdejl e degjoi te thirruren, dhe u kthye te shikonte.

Kurre , asnjehere nuk kam pare burre te tmerrohej ne ate menyre! U lekund, i zverdhur deri ne rrenjet e flokeve e mu duk se u zvoglua brenda rrobeve te tij. Ngriti duart e tha duke gjemuar:

" O zot i madh! O Zot!"- pastaj e mblodhi veten me mundim te madh. "Lamtumire, Lucy! Lamtumire!" thirri. E qendroi aty ne bankine, duke tundur duart drejt ne shenje pershendetje , deri sa Noeu u largua dhe fytyrat ne parapetin e skafit u bene te turbullta e nuk dalloheshin me.

"Kujtoja se ti e dije", tha McVeigh, qe po e shikonte me kuriozitet. "Pikerisht ju duhej ta kishit ditur. Kujtova se kishe ardhur per te. "

"Tani e di,"- u pergjigj Kersdejl me nje ton tmerresisht te rende. «Ku eshte karroca?» u nis me te shpejte, thujse duke vrapuar drejt karroces, e une u detyrova te vrapoj per ti qendruar prane. "Tek dottor Hervey", i tha karrocierit. "Jepi shpejt." U leshua ne sedilje duke dihatur e duke dihatur, pa fryme. E verdha e fytyres sa vinte shtohet. Me buzet e mbledhura , balli dhe buza e siperme mbuluar me djerse. Dukej si ne nje agoni te tmerreshme. "Pash hatrin e zotit, Martin, beji te vrapojne keta kuaj.!" Per nje cast shpertheu. "Bjeri me kamxhik! A degjon! Bjeri me kamxhik!" "Po nuk mundem, zoteri. Eshte e ndaluar", kundersiztoi karrocieri. "E paguaj une gjoben,» u pergjigj Kersdejl. "Do ta paguaj une gjoben. Me shpejt, me shpejt!" "E une nuk dija asgje, nuk dija asgje," murmuriti, duke u zhytur ne sedilje e duke fshire ballin me duart qe i dridheshin. Karroca hidhet perpjete, lekundej e shkundej, pas cdo kthese me nje ritem aq te eger sa ishte e pamundur te bisedohej. Por nuk kishte asgje per te thene. Mundja vetem ta degjoja qe belbezonte sa e sa here: -" Po une nuk e dija. Nuk dija asgje! Nuk dija asgje!"